



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.15/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Cocaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruar nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, ZP.Anr.15/2025 e datës 10.12.2025, me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të anuloj vendimin me nr. Protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të miratoj vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të vendvotimit në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, me të cilën pretendojnë se me 08.10.2025, KQZ ka miratuar vendimin nr. 01/3693-2025 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Theksojnë se si parti parlamentare përfaqësuese e komunitetit egjiptian konsiderojnë se i është bërë e padrejtë me rastin e përfshirjes në komunat e Prizrenit, Deçanit dhe Obiliqit, ashtu që nuk i është ndarë asnjë anëtar për këshilla të vendvotimeve, përkundër faktit se në këto tri komuna kanë votues në masë të mjaftueshme për të pasur anëtar. Po ashtu, edhe në komunën e Fushë Kosovës e vlerësojnë se

nuk është ndarë numri i anëtarëve për këshilla të vendotimeve në krahasim me rezultatet e arritura në tri palë zgjedhjet e fundit parlamentare.

Theksojnë se formula e aplikuar në rastet tjera për komunat u janë ndarë vendeve partive që nuk kanë marrë pjesë fare në zgjedhjet deri më tani apo partive që kanë shumë më pak votues në numër apo fare ndërsa në komunat e Prizrenit, Deçanit, Obiliqit për zgjedhjet parlamentare konsiderojnë se nuk është përdorur formula e njëjtë. Në komunën e Fushë Kosovës me c' rast u janë ndarë vetëm anëtar të këshillave të vendotimeve që është jo proporcionale me partitë e vogla të komuniteteve, duke shtuar se me këtë formulë të KQZ-së janë dëmtuar rëndë. Kanë kërkuar nga PZAP që ta pranojnë ankesën si të bazuar dhe ta urdhëroj KQZ-në të ndryshoj vendimin e lartcekur.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se bazuar në Ligji nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka emëruar "Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KVV). Kriteret të cilat janë marrë në përcaktimin e përbërjes së këtij trupi menaxhues zgjedhor është e bazuar në Rregulloren Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve kriteret si vijon: Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, kanë të drejtë të nominojnë nga një (1) anëtar në KVV. Po ashtu, përfaqësim edhe subjekteve politike të reja të certifikuara për zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV, ku KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Tek përfaqësimi i komuniteteve në KVV, përcakton numrin e dallueshëm të popullsisë brenda komunave; Numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal. KQZ ka vazhduar duke marrë për bazë edhe kriteret tjera shtesë: KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara, nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme (28 Dhjetorit), KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional dhe garantimit të një procesi zgjedhor të rregullt dhe të besueshëm përbërja e një Këshilli të Vendvotimit (KVV) bazohet në strukturën standarde dhe orientuese prej pesë (5) anëtarëve. Me përjashtim të pesë (5) komunave Deçan, Gllogoc, Kaçanik Junik dhe Hani i Elezit ku numri i përfaqësimit në këtë mekanizëm zgjedhor është katër (4), ndërsa vetëm në komunën e Prizrenit për shkak të numrit të madh të komuniteteve KQZ ka paraparë rritjen prej gjashtë (6) anëtarë në Këshillat e Vendvotimit. Tutje në ankesë theksohet se Në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, komuniteti Egjiptian siguron përfaqësimin e tij institucional përmes dy subjekteve politike: Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK). Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, të dy subjektet së bashku kanë marrë gjithsej 273 vende në Këshillat e Vendvotimeve (KVV). 2 Partia Liberale Egjiptiane është e përfaqësuar në Këshillat

e Vendvotimeve (KVV) në gjithsej 8 komuna të Republikës së Kosovës, 99 anëtarë të KVV-ve të rregullta, 4 anëtarë reserve. Përfaqësimi më i lartë i partisë është në komunat Gjakovë 30 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë Pejë - 20 anëtarë të rregullt dhe 2 rezervë Prishtinë — 15 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut dhe Rahovec niveli i përfaqësimit është 5 deri në 10 anëtarë të rregullt për secilën komunë. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është e përfaqësuar në Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në 11 Komuna me këto shifra si vijon: 160 anëtarë të rregullt të KVV-ve, 10 anëtarë rezervë, 0 kryesues. Shpërndarja e përfaqësimit të IRDI-së sipas komunave është si vijon: Gjakovë - 42 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Pejë 30 anëtarë të rregullt dhe 3 rezervë, Prishtinë — 15 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Gjilan 14 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Istog - 15 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Klinë - 9 anëtarë të rregullt, Fushë Kosovë - 8 anëtarë të rregullt, Mitrovicë e Jugut - 5 anëtarë të rregullt, Rahovec — 7 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Prizren - 5 anëtarë të rregullt, Ferizaj - 10 anëtarë të rregullt dhe 2 rezervë. Dy subjektet politike të komunitetit Egjiptian kanë siguruar përfaqësim të rëndësishëm në administrimin e procesit zgjedhor, duke mbuluar një numër të konsiderueshëm vendvotimesh nëpër komuna të ndryshme. Pavarësisht dallimeve në nivel të përfaqësimit të dy subjektet kontribuojnë në garantimin e një procesi zgjedhor funksional dhe transparent për komunitetin Egjiptian në Kosovë. Tutje në ankesë theksohet se për rrjedhojë, pretendimet për diskriminim të komunitetit Egjiptian si komunitetet joshu micë nuk qëndrojnë, pasi ata përbëjnë komunitetin me një numër të përfaqësimit të mjaftueshëm në KVV përball formulës së miratuar nga IKQZ në komunat respektive ku edhe ka popullatë të këtij komuniteti. Pretendimet e ankuesit për përbërja e KVV-ve nga viti 2019 dhe 2021 nuk mund të merret si reference për arsye se në vitin 2019 dhe 2021 përbërja e KVV-ve është bërë sipas ligjit të vjetër të Zgjedhjeve dhe akteve nënligjore të KQZ-së si dhe në vitin 2019 dhe 2021 rezultatet e subjekteve politike dhe subjektet e certifikuar të cilat kanë garuar në ato zgjedhje kanë qene te ndryshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, vëren se:

- ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se vendimi i KQZ-së, me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, lidhur me mos emërimin e drejtë të anëtarëve të tyre nga radhët e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) janë të pabazuara.

Me nenin 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, përcaktohet se *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ."* Po ashtu me nenin 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuar që kanë fituar numrin më të madh të votave për*

Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që “Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni”.

Po ashtu edhe me nenin 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore nr.16/2024, për Qendrat Komunale të Numërimit, përcaktohet se “KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse”. Paragrafi 2 i Rregullores përcaktohet se “Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale”. Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore përcakton se “Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve”.

Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve përcaktohet se “KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal”.

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga nenin 65 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve.

Kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të numrit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektin politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ në 8 komuna, 99 anëtarë të KVV-ve të rregullta, 4 anëtarë reserve.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituar, pasi që subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) është i përfaqësuar në KVV në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të fundit në nivel komunal dhe nacional, e po ashtu edhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024.

Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për diskriminimin e komunitetit egjiptian, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit egjiptian është i përfaqësuar në 8 komuna, 99 anëtarë të KVV-ve të rregullta, 4

anëtarë rezervë. Përfaqësimi më i lartë i partisë është në komunat Gjakovë 30 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë Pejë - 20 anëtarë të rregullt dhe 2 rezervë Prishtinë — 15 anëtarë të rregullt dhe 1 rezervë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut dhe Rahovec niveli i përfaqësimit është 5 deri në 10 anëtarë të rregullt për secilën komunë, duke marrë për bazë se në nenin 3 paragrafi 1 të Rregullores 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve ndër të tjera përcaktohet se *“...se KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV për të gjitha komunitetet duke u bazuar në numrin e dallueshëm të popullatës brenda një komune dhe numrin e votave të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të parashtuesit të ankuesit, por nuk ka gjetur se vendimi i atakuar është përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtuara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119. 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
ZP.Anr.15/2025, datë 13.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.